



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



**Prishtinë, 20 janar, 2023**

## **DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE**

### **THIRRJE PËR APLIKIM**

#### **DHURIMI I MJETEVE BUJQËSORE PËR FAMILJET NË KUSHTE JO TË FAVORSHME SOCIO-EKONOMIKE**

Duke u bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Fondacionit “Amaneti” dhe Komunës së Prishtinës, me nr.14-024/01-253182/22, të datës, 18.11.2022, u bën thirrje të gjitha familjeve përfituese dhe familjeve në kushte jo të favorshme socio-ekonomike të Komunës së Prishtinës që të aplikojnë për:

1. 3 (tre) kultivatorë;
2. 3 (tre) lopë qumështore;
3. 5 (pesë) koshere bletësh si dhe
4. 1 (një) serë (180m<sup>2</sup>).

**Familjet në kushte jo të favorshme socio-ekonomike duhet t’i plotësojnë këto kritere:**

1. Të jetë regjistruar në regjistrin civil të Komunës së Prishtinës (banorë të Komunës së Prishtinës);
2. Nëse janë përfituese të ndonjë skeme sociale apo në kushte jo të favorshme socio-ekonomike;
3. Në kushte të barabarta, përparësi do të ketë aplikuesi me më shumë anëtarë dhe familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara.

**Dokumentet të cilat janë të domosdoshme për të aplikuar janë:**

1. Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
2. Çertifikata mbi pronësinë e paluajtshme (nëse aplikohet vetëm për serë);
3. Vërtetimi (informatë) mbi vendbanimin e përhershëm;

4. Nëse personi/familja është shfrytëzuese e ndihmës sociale, kopje e kartelës sociale me afat vlefshmërie;
5. Nëse personi është shfrytëzues i Vendimit të pensioneve të personave me aftësi të kufizuara, të lëshuar nga MPMS-së, kopje e vendimit me afat vlefshmërie;
6. Të mos jetë përfitues i ndonjë subvencionit nga Drejtoria e Bujqësisë/donator për 3 vitet e fundit;
7. Deklaratë për të hyrat financiare të familjes.

**Si të aplikoni:**

Të deklarohet për cilin grant bujqësor po aplikoni ( rretho, mundeni me shumë se një)

5. 3 (tre) kultivator;
6. 3 (tre) lopë qumështore;
7. 5 (pesë) koshere bletësh si dhe
8. 1 (një) serë (180m<sup>2</sup>).

**Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:**

Komuna e Prishtinës (objekti i vjetër), Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Rr.UÇK nr. 2, 10000, Prishtinë, Qendra për Shërbime me Qytetarë, kati përdhësë, sporteli nr.3.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data **20.01.2023 deri me 30.01.2023, gjegjësisht 7 ditë pune.**

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.